



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 19.01.2022

RAPORT

(Komision për dhënie mendimi)

PËR

AKTIN NORMATIV

NR. 35, DATË 24.12.2021

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 90/2019, “PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR”

•Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 19.01.2022, mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 35, datë 24.12.2021 “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 90/2019, “për Rivlerësimin E Pasurisë Së Paluajtshme”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Z. Jurgis Cyrbja.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe Znj. Vasilika Vjero, Zv. Minsitre e Financave dhe Ekonomisë si dhe Z. Niko Lera, Drejtor i Përgjithshëm i Harmonizimit Fiskal pranë MFE.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Akti normativ i propozuar për miratim, është akt normativ me fuqinë e ligjit, në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe vjen si rezultat i propozimeve dhe kërkesave të ardhura nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim që të gjithë qytetarët, që kanë nisur procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në kuadër të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të kenë mundësi ta përfundojnë këtë proces.

Miratimi i ligjit nr.90/2019 synonte të sillte efekte të drejtpërdrejta në nxitjen dhe formalizimin me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme. Nisur edhe nga përvoja ndër vite, rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme ka përbërë një ndër aktet ligjore më me interes për qytetarët, duke sjellë një rritje të konsiderueshme të këtyre rivlerësimeve, shoqëruar edhe me regjistrime të shumë transaksioneve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Ligji nr.90/2019 ka parashikuar mundësinë e rivlerësimit me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme për individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, si dhe për personat juridikë, të cilët kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme. Ky ligj ka parashikuar të drejtën e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri më 31 dhjetor 2020.

Ndërkohë, pas miratimit të ligjit nr.90/2019, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar”, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, realizimi i procesit të rivlerësimit ka hasur vështirësi për sa i përket procesit të aplikimit nga ana e personave të interesuar për të kryer rivlerësimin e pasurive të paluajtshme. Kjo, pasi nga periudha 17 janar 2020, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr.90/2019, deri më 17 mars 2020, periudhë në të cilën nisi marrja e masave të veçanta gjatë infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, numri i aplikimeve për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme ishte rreth 15071.

Ndërkohë, për periudhën 18 mars – 22 maj, numri i aplikimeve ishte rreth 4835. Pra, siç shihet, situata e krijuar nga COVID-19, solli rënie të dukshme të numrit të aplikimeve për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme me rreth 68%.

Për këto arsye, me ligjin nr.91/2020, u mendua e arsyeshme shtyrja e afatit të aplikimit deri më 30 shtator 2021. Ky afat u shty më tej deri më 31 dhjetor 2021, më anë të ligjit nr.164/2020, pasi nga të dhënat e dërguara nga ASHK-ja, rezultoi se kishin aplikuar rreth 51917 individë për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, ndërkohë, nga këta, rreth 26267 prej tyre kishin kryer pagesën e tatimit.

Pra, rreth 49% nuk kishin kryer pagesën e tatimit. Kjo mund të ketë ardhur edhe si shkak i pamundësisë financiare të krijuar nga COVID-19. Për t’u dhënë mundësinë individëve, që kishin aplikuar për të kryer pagesën, si dhe të tjerëve për të kryer procesin e rivlerësimit në vazhdim, u propozua shtyrja e afatit deri në 30 shtator 2021.

Për periudhën nga muaji janar 2021 deri në muajin dhjetor 2021, numri i aplikimeve për rivlerësimin e pasurive ka arritur 64014 aplikime, ndërkohë që nga ky numër aplikimesh, 34224 aplikantë kanë kryer pagesat e rivlerësimit në një vlerë prej 3.69 miliard lekë. Pra, kemi rreth 47% e totalit të aplikantëve, të cilët nuk kanë kryer akoma pagesat e rivlerësimit, për të cilët mendohet të ketë ndikuar edhe situata ekonomike e shkaktuar nga COVID-19.

Me nevojën dhe urgjencën për t’i dhënë kohën e mjaftueshme të gjithë atyre qytetarëve që kanë nisur ose që kanë interes të kryejnë procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme, propozojmë zgjatjen e afatit të aplikimit të ligjit nr.90/2019 deri më 30 prill 2022.

III. VLERËSIMI I KUSHTETUTESHMËRISË SË AKTIT NORMATIV

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj **me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës** si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Sipas dispozitave kushtetuese, akti normativ me fuqinë e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin, është një instrument që mundëson përsheptimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit.

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Pandemia aktuale e shkaktuar nga Sars-Cov-2 (Covid-19) ka shkaktuar dëme të mëdha në shëndetin e njerëzve, duke kaluar deri në humbjen e jetës dhe dëme ekonomike qoftë për buxhetin e personave të prekur, qoftë për buxhetin e bizneseve për shkak të vendosjes së masave kufizuese të frekuentimit të tyre, ashtu si dhe dëme në buxhetin e shtetit.

Duke marrë shkas që procedura për miratimin e një projektligji kërkon një periudhë të gjatë kohore, që nga propozimi deri në miratim, si dhe rrethanave të nevojës dhe të urgjencës për shkak fluksit të lartë të aplikimeve, numrit të lartë të pagesave të pakryera nga aplikantët, si dhe të limitit kohor aktual ligjor, që është data 31 dhjetor 2021, vlerësohet e pamundur që projektligji të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përsheptuara.

Emergenca e lindur si pasojë e situatës së pasigurt dhe detyrimi kushtetues për plotësimin e nevojave të shtetasve të shkaktuar nga emergjenca shëndetësore **konsiderohet si shkak për urgjencë.**

Në periudhën nga muaji janari 2021 deri në muajin dhjetor 2021, numri i aplikimeve për rivlerësimin e pasurive ka arritur masën 64014 aplikime, ndërkohë që, nga ky numër aplikimesh, 34224 aplikantë kanë kryer pagesat e rivlerësimit në një vlerë prej 3.69 miliard lekësh.

Pra, kemi rreth 47% e totalit të aplikantëve, të cilët nuk kanë kryer akoma pagesat e rivlerësimit, për të cilët ka ndikuar edhe situata e paparashikuar ekonomike e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Në të tilla rrethana aspak normale, lind nevoja që të gjithë qytetarët, që kanë nisur procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në kuadër të ligjit nr.90/2019 “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, **t’u garantohet e drejta dhe koha e nevojshme për të përfunduar këtë proces.**

Pra, kushti kumulativ për ekzistencën e “nevojës” në shtyrjen e afatit të aplikimit deri më 30 prill 2022, përmbushet plotësisht, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me rreth gati gjysmën e aplikantëve, të cilët nuk e kanë kryer ende pagesën, duke sjellë në këtë mënyrë një impakt të konsiderueshëm financiar për buxhetin. Gjithashtu, fluksi i aplikimeve që priten në periudhën janar-prill 2022 është një fluks i lartë, rreth 20 000 aplikime me një vlerë prej 970 milionë lekë, referuar të dhënave të ASHK-së për vitin 2021.

Për sa i përket përmbushjes së kushtit tjetër kumulativ “urgjencës”, sjellim në vëmendje se afati aktual i aplikimit të parashikuar nga ligji nr.90/2019 është 31 dhjetor 2021. Duke qenë se ka kaluar mesi i muajit dhjetor 2021, limit kohor i afatit ligjor të aplikimit, ndodhemi në kushtet e pamundësisë totale kohore dhe juridike për të kryer zgjatjen e afatit kohor të aplikimit nëpërmjet procedurës së zakonshme të miratimit të projektligjeve.

Ne perfundim, akti normativ nr. 35, **plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj,** veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.23, datë

16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë¹:

- a) *Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit*
- b) *Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit*
- c) *Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre*
- ç) *Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi*

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:

Neni 101 ka parashikuar nevojën e urgjencën si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Situata me të cilën vazhdon të përballet vendi ynë si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti normativ lidhet me kushtin e domosdoshmërisë së shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj.

Akti Normativ që po shqyrtojmë vlerësohet se është një akt që del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës **dhe i plotëson të gjitha kriteret** e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24 datë 10.11.2006, vendimi nr.23 datë 16.4.2014, etj.

IV. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore për të ofruar një menaxhim të situatës me qëllim që të gjithë qytetarët, që kanë nisur procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në kuadër të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të kenë mundësi ta përfundojnë këtë proces.

Deputeti relator Z. Cyrbja solli në vëmendje të Komisionit se afati aktual i aplikimit të parashikuar nga ligji nr.90/2019 është 31 dhjetor 2021 dhe se ndodhemi në kushtet e pamundësisë totale kohore dhe juridike për të kryer zgjatjen e afatit kohor të aplikimit nëpërmjet procedurës së zakonshme të miratimit të projektligjeve nga Kuvendi.

Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qëndrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

¹ Vendimi nr.24, datë 10.11.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në Komisionin Përgjegjës dhe më pas t'i përcillet seancës plenare sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

RELATOR

KRYETARE

JURGIS CYRBJA

KLOTILDA BUSHKA